

V E N D I M
Nr.689, datë 14.10.1996

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.208, DATË 25.4.1995 “PËR MËNYRËN E TRAJTIMIT ME NDIHMË EKONOMIKE TË FAMILJEVE QË KANË LËVIZUR NGA VENDBANIMI I TYRE”, NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.605, DATË 30.10.1995 “PËR KRITERET E VLERËSIMIT TË NDIHMËS EKONOMIKE”, DHE NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.304, DATË 30.6.1994 “PËR DOKUMENTACIONIN E PËRFITIMIT TË NDIHMËS EKONOMIKE”

Me propozimin e Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shkronja “a” e pikës 2 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.208, datë 25.4.1995, ndryshohet si vijon:

“Vërtetim të firmosur dhe vulosur nga kryetari i komunës ose bashkisë (kur këto në përbërjen e tyre kanë fshatra, banorët e të cilëve janë trajtuar me tokë), kryeplaku dhe përgjegjësi i zyrës së kadastrës, në të cilin të shprehet se familja ____ nuk disponon tokë as në pronësi, as në përdorim sipas vendimit të komisionit të ndarjes së tokës datë ____, meqë është larguar nga vendbanimi para datës 1.8.1991 për arsye pune”.

2. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.605, datë 30.10.1995, bëhen këto ndryshime:

a) Shkronja “ç” e pikës 1 ndryshohet si vijon:

“Nuk është regjistruar në zyrën e punës si i (e) papunë dhe si kërkues pune. Përfshihen nga ky rregull anëtarët e familjes bujqësore”.

b) Shkronja “e” e pikës 1 ndryshohet si vijon:

“Ndryshon vendbanimin, duke braktisur në vendbanimin e vjetër pronat e tij dhe burimet e jetesës.

Përfshihen nga ky rregull rastet e mëposhtme:

- kur ndryshon vendbanimin për arsye të detyruara ose të kërkuara nga shteti;
- kur përbën rast të veçantë, sipas vendimit të këshillit të komunës së vendbanimit të vjetër;
- kur plotëson kushtet e përcaktuara në pikën 2 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.208, datë 25.4.1995”.

c) Pika 3 ndryshohet si vijon:

“Dokumentacioni i nevojshëm që duhet të paraqesë familja pretenduese për ndihmë ekonomike, është deklarata e përgjithshme dhe specifike. Ky dokumentacion përgatitet nga kryefamiljari i familjes.

Deklarata e përgjithshme përgatitet një herë në vit (në muajin e parë të pretendimit) dhe sa herë që ndryshojnë kushtet sociale ekonomike të familjes. Pjesa tjetër e dokumentacionit përgatitet sipas afatit të përcaktuar në këtë vendim.

Dokumentacioni përgatitet sipas modeleve të Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale”.

3. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.304, datë 30.6.1994, bëhen këto ndryshime:

a) Shkronja “a” e pikës 2 ndryshohet si vijon:

“Certifikata e gjendjes familjare, në të cilën të shënohet data e regjistrimit në regjistrin themeltar të gjendjes civile të vendbanimit të ri”.

b) Shkronja “e” e pikës 2 ndryshohet si vijon:

“Vërtetim nga zyra e sigurimeve shoqërore për:

- pensionet;
- pagesën e kontributeve gjatë periudhës që ka qenë i punësuar”.

c) Shkronja “d” e pikës 4 ndryshohet si vijon:

“Listën e pensionistëve dhe listën e personave që nuk kanë paguar kontributet gjatë periudhës që kanë qenë të punësuar, nga zyra e sigurimeve shoqërore”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrihet efektet nga data 1 gusht 1996.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi